

VENDIM
Nr. 833, datë 23.11.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I STACIONIT TË POMPIMIT TRUSH (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i stacionit të pompimit Trush (shtesa)”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të ndërmarrjes “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me sipërfaqe 2 960 (dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 799 200 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 799 200 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i ndërmarrjes “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i ndërmarrjes “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër.
 6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë ndërmarrjes “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër.
 8. Ndërmarrja “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër, të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.
 9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me ndërmarrjen “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga ndërmarrja “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, ndërmarrja “Ujësjellës fshat” sh.a., Shkodër, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I STACIONIT TË POMPIMIT TRUSH-SHKODËR”(SHITESA)

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)
1	Nazif Halit Pervizi	3205	1298/3	arë	775	270	209250
2	Zija Halit Pervizi	3205	1298/4	arë	1700	270	459000
3	Arif Selim Mustafaj	3205	1298/45	arë	485	270	130950
		SHUMA TOTALE					799200

